



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
DREJTORIA E PROKURIMEVE PUBLIKE

Nr. _____ Prot.

Elbasan, më ____ . ____ . 2024

LËNDA: Dërgim njoftimi i fituesit për botim në Buletinin e Njoftimeve Publike.

AGJENCISË së PROKURIMIT PUBLIK

T I R A N Ë

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT (PARAPRAK)

Nga: **Bashkia Elbasan** adresa: rruga “Qemal Stafa”, Elbasan.

Drejtuar: **“BLERIMI” sh.p.k** me adresë: Elbasan, Shirgjan Mjekes, Fshati Mjekes, Zona Topcias, Rruga Elbasan - Cerrik km 4, prane lumit Shkumbin.

Procedura e prokurimit: “ Proçedurë e hapur – Sherbime ”.

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-15935-08-12-2024

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **“Riparime dhe mirëmbajtje të objekteve arsimore”**, me fond limit: **10'668'159** (dhjetëmilion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e njëqind e pesëdhjetë e nëntë) **lekë pa t.v.sh.**, vënë në dispozicion nga Buxheti i Bashkisë Elbasan, dhe me afat për kryerjen e shërbimit **3 muaj** nga nënshkrimi i kontrates.

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [data] [nr]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. “BLERIMI” sh.p.k me Nipt: J 62903384 G

Vlera e paraqitur në procedurën e prokurimit është **10,240,290** (dhjetemilion e dyqind e dyzetmije e dyqind e nentedhjetë) **lekë (pa tvsh)**.

2. “INA” Sh.p.k me Nipt: J61814009W

Vlera e paraqitur në procedurën e prokurimit është **6,261,729** (gjashtemilion e dyqind e gjashtedhjetë e njemije e shtateqind e njezet e nente) **lekë (pa tvsh)**.

3. “METEO” Sh.p.k me Nipt: L 26310801 C

Vlera e paraqitur në procedurën e prokurimit është **10,667,772** (dhjetemilion e gjashteqind e gjashtedhjetë e shtatemije e shtateqind e shtatedhjetë e dy) **lekë (pa tvsh)**.

4. “Çela Group” Sh.p.k me Nipt: M 22610207 Q

Vlera e korrigjuar është **9,107,172** (nentemilion e njeqind e shtatemije e njeqind e shtatedhjetë e dy) **lekë (pa tvsh)**.

5. “ERGI” Sh.p.k me Nipt: K 02727229 P

Vlera e paraqitur në procedurën e prokurimit është **10,528,032** (dhjetemilion e peseqind e njezet e tetemije e tridhjetë e dy) **lekë (pa tvsh)**.

6. “XHAŠT” Sh.p.k me Nipt: K 12512837 I

Vlera e paraqitur në procedurën e prokurimit është **9,079,224** (nentemilion e shtatedhjetë e nentemije e dyqind e njezet e kater) **lekë (pa tvsh)**.

Janë s’kualifikuar operatorët ekonomikë si mëposhtë:

1. XHAŠT

1. Ne permbushje te kerkeses se parashikuar ne piken 2.3.1 te kapacitetit teknik, te kritereve te veçanta per kualifikim, keni paraqitur dy kontrata pune, njera me objekt “Ndertimin e infrastruktures publike ne zonen e Ndroqit” dhe tjetra “Rindertimin e banesave individualene njesine administrative Ndroq”. Objekti i prokurimit eshte sherbimi i lyerjes se objekteve arsimore, lyerja e brendshme dhe e jashtme e objekteve arsimore. Sipas preventivave te paraqitur per te dyja kontratat, rezulton se zerat te cilat jane te ngjashme me sherbimin objekt prokurimi jane ne nje vlere prej 267,100 leke pa tvsh, nderkohe qe vlere qe duhet te permbushet eshte 4,267,263 leke pa tvsh (40% e fondit limit).

Nuk plotesoni kriterin e sipercituar.

Sa më sipër, oferta juaj refuzohet.

Në ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", neni 92, pika 3, parashikohet se: Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.

Në VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, neni 82 parashikohet se: Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme.

2. INA

1.Pas shqyrtimit dhe vleresimit te ofertes tuaj KVO vendosi ta kualifikoje ate. Me pas KVO bazuar ne nenin 82 pika 4 e VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, verifikoi nëse oferta është ose jo me çmim anomalisht të ulët sipas formulës së përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit. Duke qenë se në rastin konkret janë vlerësuar vetem dy oferta të vlefshme, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përlllogaritur. Oferta e dhene nga ana juaj eshte 6,261,729 leke pa tvsh dhe eshte me e ulet se 25% e fondit limit të përlllogaritur duke u vlerësuar anomalisht e ulët.

Ne nenin 93 pika 5 te VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, parashikohet shprehimisht:

"Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, autoritetet ose entet kontraktore refuzojnë pa kërkuar shpjegime një ofertë, e cila është konstatuar anomalisht e ulët."

Sa mesiper, oferta juaj refuzohet.

3. Cela Group

1. Keni paraqitur formularin e ofertes se bashku me preventivin ne Shumen 8,250,372 leke pa tvsh.

Ne zerin nr. 3 te preventivit, Boje hidroplastike (fasade), keni dhene çmimin 4200*200=84,000 nderkohe qe duhet te duhet te ishte 4200*200=840,000. Ky gabim ben qe vlera e ofertes te jete 9,107,172 leke pa tvsh, duke rezultuar ne nje marzh gabimi prej 9.4%.

Ne nenin 82 pika 3 te VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht:

Ofertat me gabime aritmetike refuzohen, kur:

- shumat absolute të të gjitha korigjimeve janë më shumë se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar;

2. Keni paraqitur formularin permbledhes te deklarimit ku keni deklaruar se do te mbeshteteni ne kapacitetet e subjektit “Bajrami N” shpk persa i perket punonjesve.

Nderkohe qe subjekti “Bajrami N” shpk ka mbeshtetur me te njejtat kapacitete edhe nje subjekt tjeter pjesemarres ne kete procedure prokurimi e konkretisht subjektin “Meteo” shpk.

Ne nenin 90, pika 7, paragrafi i dyte te ligjit nr.162/2020, dt.23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht:

“Subjekti mbështetës nuk mund të mbështesë më shumë se një operator ekonomik në të njëjtën procedurë prokurimi”.

3. Ne permbushje te kerkeses se parashikuar ne piken 2.3.1 te kapacitetit teknik, te kriterëve te veçanta per kualifikim, keni paraqitur kontraten e siper marrjes me objekt: “Rindertimi i baneses se demtuar.....” Objekti i prokurimit eshte sherbimi i lyerjes se objekteve arsimore.

Sipas preventivit te paraqitur, bashkangjitur kontrates, rezulton se zerat te cilat jane te ngjashme me sherbimin objekt prokurimi jane ne nje vlere prej 109.450 leke pa tvsh, nderkohe qe vlera qe duhet te permbushet eshte 4,267,263 leke pa tvsh (40% e fondit limit).

Sa mesiper, oferta juaj refuzohet.

Në ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", neni 92, pika 3, parashikohet se: Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.

Në VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 82 parashikohet se: Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson

ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme.

3. METEO

1. Keni paraqitur formularin permbljedhes te deklarimit ku keni deklaruar se do te mbeshteteni ne kapacitetet e subjektit “Bajrami N” shpk persa i perket punonjesve.

Nderkohe qe subjekti “Bajrami N” shpk ka mbeshtetur me te njejtat kapacitete edhe nje subjekt tjetër pjesëmarrës ne kete procedure prokurimi e konkretisht subjektin “Çela Group” shpk.

Ne nenin 90, pika 7, paragrafi i dyte te ligjit nr.162/2020, dt.23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht:

“Subjekti mbështetës nuk mund të mbështesë më shumë se një operator ekonomik në të njëjtën procedurë prokurimi”.

2. Ne permbushje te kerkeses se parashikuar ne piken 2.3.1 te kapacitetit teknik, te kriterëve te veçanta per kualifikim, keni paraqitur kater kontrata pune me objekt: 1.“Ndertim godine per venderuajtje te dokumentave ne shkoze”; 2.“Rikonstruksion i godines se spitalit Prrrenjas Librazhd”; 3. “Rikonstruksion i godines se pedriatise” dhe 4.”Rikonstruksion per qendren e kontrollit Teknik ne DRSHTRR Vlore”. Objekti i prokurimit eshte sherbimi i lyerjes se objekteve arsimore, lyerja e brendshme dhe e jashtme objekteve arsimore.

Kontratat me objekt: 1.“Ndertim godine per venderuajtje te dokumentave ne shkoze”; 2. “Rikonstruksion i godines se spitalit Prrrenjas Librazhd” jane realizuar jashte afatit 3 vjecar nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës sic eshte kerkuar ne kerkesen e sipercituar ku parashikohet: Operatori ekonomik duhet te paraqese dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave te sherbimeve te mëparshme, të ngjashme me objektin e prokurimit, me një vlerë sa 40% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Per dy kontratat e tjera, sipas preventivave te paraqitur per te dyja kontratat, rezulton se zerat te cilat jane te ngjashme me sherbimin objekt prokurimi jane ne nje vlere prej 1,594,594 leke pa tvsh, nderkohe qe vlere qe duhet te permbushet eshte 4,267,263 leke pa tvsh (40% e fondit limit).

Sa mesiper, oferta juaj refuzohet.

Në ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", neni 92, pika 3, parashikohet se: Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.

Në VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, neni 82 parashikohet se: Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme.

3. ERGI

1. Ne përmbushje të kërkesës së parashikuar në pikën 2.3.1 të kapacitetit teknik, të kriterëve të veçanta për kualifikim, kemi paraqitur kontratën e punës me objekt: "Rikonstruksion i shkollës 9 vjeçare "Jorgji Dilo", Bashkia Elbasan" është realizuar jashtë afatit 3 vjeçar nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës sic është kërkuar në kërkesën e sipercituar, ku parashikohet: Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të shërbimeve të mëparshme, të ngjashme me objektin e prokurimit, me një vlerë sa 40% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Nuk plotësoni kriterin e sipercituar.

Sa më sipër, oferta juaj refuzohet.

Në ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", neni 92, pika 3, parashikohet se: Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.

Në VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, neni 82 parashikohet se: Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë subjektin: **“BLERIMI” sh.p.k me Nipt: J62903384G** me adresë: Elbasan, Shirgjan Mjekes, Fshati Mjekes, Zona Topcias, Rruga Elbasan - Cerrik km 4, prane lumit Shkumbin, se oferta e paraqitur, me një vlerë totale prej **10,240,290** (dhjetemilion e dyqind e dyzetmije e dyqind e nentedhete) **lekë (pa tvsh)**, është identifikuar si fitues (paraparak) i procedurës së prokurimit.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR
KRYETARI
Gledian Llatja